



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:250016

Datë: 08.10.2024

Numri i dokumentit: 06269109

**C.nr.599/22**

**Gjykata Themelore Gjakove-Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Nehat Qelaj në çështjen juridike të paditësve M.B.H.B.nga fshati B., Komuna Malishevë, të cilët me autorizim i përfaqëson Av. Bahrije Xhyliqi avokate nga Malisheva, kundër të paditurve A.LR.L.nga fshati B., Komuna e Malishevës, për Vërtetim Pronësie në bazë të shitblerjes, vlera e kontestit 5.000€ , jashtë shqyrtimit kryesor me datë 08.10.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**KONSTATOHET SE ËSHTË TËRHEQUR** Padia paditësve M.B.H.B.nga fshati B., Komuna Malishevë, e ushtruar me datë 30.08.2022, kundër të paditurve A.LR.L.nga fshati B., Komuna e Malishevës, për Vërtetim Pronësie në bazë të shitblerjes, vlera e kontestit 5.000€ .

**A r s y e t i m**

Paditësit e lartpërmendur, të përfaqësuar nga avokate Bahrije Xhyliqi nga Malisheva, në këtë gjykatë me datë 30.08.2022, kanë parashtruar padinë dhe kërkesëpadinë kundër të paditurve të lartcekur për Vërtetim Pronësie në bazë të shitblerjes, vlera e kontestit 5.000€.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë, me datë 07.02.2023 i njoftoj të paditurit me aktvendim për përgjigje në padi. Pas pranimit të këtij aktvendimi të paditurit në përgjigje në padi ndër tjera kanë deklaruar se te paditurit nuk e kontestojnë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve dhe deklarojnë se si bashkëpronar të këtyre dy palujtshmerive ,paditësve ka më tepër se 20 vite që u a kemi shitur sipërfaqet e këtyre dy ngastrave dhe që janë në posedim dhe shfrytëzim të tyre, e për të cilat jemi kompensuar në tersi nga paditësit dhe në mes nesh nuk ka asnjë kontestuese. E për më shumë si në këtë përgjigje.

Paditësit nëpërmjet të autorizuarës av.Bahrije Xhyliqi, me datë 30.01.2024, përmes parashtrësës për tërheqjen e padisë e ka informuar gjykatën se ndërgjyqësit tani më i kanë zgjidhur dhe rregulluar të gjitha mos marrëveshjet që i kanë pasur mes vete lidhur me çështjen për të cilën ishte ngritur padia dhe se nuk ekziston asnjë mosmarrëveshje mes tyre, dhe konsiderojmë se procedura gjyqësore tani në këtë çështje nuk është e nevojshme të zhvillohet dhe njoftojmë Gjykatën se bëjmë tërheqjen e padisë së deponuar më datë 30.08.2022 me nr.Cnr.599/2022.

Meqenëse të paditurit ka paraqitur përgjigje në padi, gjykata një kopje të parashtrësës për tërheqjen e padisë ja ka dërguar të paditurve me qëllim të deklarimit për tërheqjen e padisë. Të

paditurit nuk janë deklaruar brenda afatit 7 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit me datë 04.03.2024, andaj meqenëse të paditurit në afatin e lart cituar nuk janë deklaruar për tërheqjen e padisë, në kuptim të nenin 261.2 të LPK-së konsiderohet se të njëjtit e ka dhënë pëlqimin.

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtrësës konform nenit 261 parg. 2, 3, 4 dhe 5 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**Gjykata Themelore Gjakove-Dega Malishevë.**  
**Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**  
**C. nr.599/22, datë 08.10.2024**

**G j y q t a r i**  
Nehat Qelaj

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet parashtrimi i ankesës.